- Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.
- 13. Ofertat me vonesë** Autoriteti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.
- 14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**
1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.
 2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".
 3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.
- 15. Hapja e Ofertave** Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

- 16. Konfidencialiteti** Autoriteti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

-
- 17. Sqarimi i ofertave**
1. Autoriteti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.
- 18. Përgjegjshmëria e ofertave**
1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:
- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit;
 - (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në Dokumentet e Tenderit; dhe
 - (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.
2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

- 19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik**
1. Për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.
2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.
4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).
- 20. Konvertimi në valutë të vetme**
1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontrates.
- 21. Kriteret e përcaktimit të**
1. Autoriteti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës

ofertës fituese dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

Ku:

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk1} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: Autoriteti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

3. Autoriteti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

**korrigjimi i
gabimeve
aritmetike dhe
ofertave
anomalisht të
ulëta**

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit

93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës
- Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 7. Termat e referencës
- Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit
- Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)
- Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
- Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER LOTIN 1:

Specifikimet teknike te ashensorit te Maternitetit

Tipi :	ELEKTROMEKANIK
Shpejtesia (meter/sekond):	1.0
Peshembajtja (kg):	1350
Kapaciteti (persona):	13
Numri I ndalesave:	4
Gjatesia e udhetimit (mm):	23700
Thellesia e gropes (mm):	1400
Headroom:	3600
Modeli i Kabines:	Panoramike + Inox Satin

Dimensionet e kabines	1400 x 1600 x 2075
Dyshemeja e kabines:	Granit
Tavani i kabines:	Inox + Plexiglass
Ventilator ne kabine :	I perfshire
Numri i dyerve ne kabine:	1
Gjerësia e dyerve (mm):	900
Lartesia e dyerve (mm):	2000
Dimensioni i kasave anesore(mm):	120
Dimensioni i kases lart(mm):	210

Specifikimet teknike te ashensorit te Maternitetit

Tipi :	ELEKTROMEKANIK
Shpejtesia (meter/sekond):	
Peshembajtja (kg):	1350
Kapaciteti (persona):	13
Numri I ndalesave:	3
Modeli I Kabines:	Inox Satin
Dimensionet e kabines	1650 x 1450 x 2075
Tavani i kabines:	Inox + Plexiglass
Ventialator ne kabine :	I perfshire
Numri i dyerve ne kabine:	1
Gjerësia e dyerve (mm):	900
Lartesia e dyerve (mm):	2000
Dimensioni i kasave anesore(mm):	120
Motori	Alberto Sassi

	Hapja e dyerve: Teleskopike anesore (
Materiali i deres se kabines:	Inox Satin
Materiali i dyerve te katit:	Inox Satin
Motori:	Alberto Sassi
Elektronika:	
Emergjenca:	Automatike
	Tipi : ELEKTROMEKANIK
Shpejtesia (meter/sekond):	
Peshembajtja (kg):	1350
Kapaciteti (persona):	13
Numri I ndalesave:	3
Modeli I Kabines:	Inox Satin
Dimensionet e kabines	1650 x 1450 x 2075
Tavani i kabines:	Inox + Plexiglass
Ventialator ne kabine :	I perfshire
Numri i dyerve ne kabine:	1
Gjerësia e dyerve (mm):	900
Lartesia e dyerve (mm):	2000
Dimensioni i kasave anesore(mm):	120
Motori	Alberto Sassi
	Hapja e dyerve: Teleskopike anesore (
Materiali i deres se kabines:	Inox Satin
Materiali i dyerve te katit:	Inox Satin
Motori:	Alberto Sassi
Elektronika:	
Emergjenca:	Automatike

Mirembajtja e ashensorit

Kontroll preventiv i ashensorit

a) *Shërbimi periodik në dhomën e makinerisë,*

b) *Kontrolli i pjesëve mekanike dhe elektrike.*

c) *Kontrolli i sistemeve dhe mekanizmave të mbrojtjes frenimit, komandimit, të lëvizjes, dyert, kavot etj.*

d) *Rregjistrimi i frenave, i dyerve, i operatorit të derës*

dh) *Pastrimi, vajisja dhe lubrifikim i shinave gjithë nyjeve lëvizëse, kontrolli i rrjedhjeve etj.*

e) *Kontroll i sigurisë, sinjalizimit, ndricimit, izolimeve dhe tokëzimeve*

f) *Testim i sistemit të emergjencës.*

FV Rrul mbajetese te deres

FV Rrul centrik per rregjistrimin e deres

F.V.suste celiku per deren e ashensorit

FV .Udhezues kabine

FV Kavo e operatorit te deres se kabine

Vaj Motori 90

FV Guida plastike per udhezimin e kabines

FV Guida plastike per udhezimin e kondrapeshes

Protokolli i mirembajtjes periodike:

I.Gjate seancave te mirembajtjes se rregullt mujore OE duhet te kryeje keto procese kontrolli:

- ***Niveli i kabines (ndalja) ne kate:***

Kontrolli i saktësisë së ndaljes nëpër kate

- ***Butoni i alarmit ne kabine:***

Kontrolli i funksionimit të butonit

- ***Butonat e kateve dhe treguesit (display):***

Kontrolli i funksionimit normal të tyre

- ***Kabina e Ashensorit:***

Kontrolli i fiksimit të panelave dhe tavanit, kontrolli i ndricimit, kontrolli i ndricimit të emergjencës, butonave në kabinë, kontrolli i rreshqitesave të kabines dhe vajerave, kutia e emergjencës mbi kabinë, funksionimi i sensoreve.

- ***Dyert e jashtme të kateve:***

Kontrolli dhe lubrifikimi

Kontrolli i kavos, rripit te motorit, integriteti dhe kompaktesia e komponenteve.

Kontrolli i hapësirës së derës

Kontrolli i paneleve të dyerve dhe shtrengimi i tyre në mekanizmin e hapjes

Kontrolli i funksionimit të dyerve të jashtme të kateve.

Kontrolli i kasave të dyerve

Kontrolli i pragjeve të dyerve dhe pastrimi i tyre.

Kontrolli i dyerve dhe levizjes lirshme të tyre

Kontrolli i funksionimit të çelësve të hapjes së dyerve në raste emergjente.

- **Dyert e kabinës:**

Kontrolli i hapjes dhe mbylljes së derës.

Kontrolli i mbylljes së kontaktit.

Kontrolli i mbylljes së mundshme.

Kontrolli i derës për levizje të lirshme

Kontrolli i binareve të derës.

Kontrolli i hapësirës së derës.

Kontrolli i lubrifikimit.

Kontrolli i kavos, zinxhirit apo rripit.

Kontrolli i kompaktesisë së mekanizmit të derës së kabines.

Kontrolli i funksionimit të senzoreve.

Kontrolli i pragut dhe pastrimi i tij.

Kontrolli i forcës mbylëse të derës.

- **Zona fundore e pusit të ashensorit:**

Kontrolli i të gjithë komponenteve që të jenë të pastër, të mos kenë pluhur apo ndryshk.

Kontrolli i ndricimit të zonës fundore të pusit.

Kontrolli i nivelit të vajit në mbledhësen e vajit nga shinat.

- **Buferët:**

Kontrolli i vendosjes së kontaktit.

Kontrolli i fiksimit të "buffer"-it.

- **Rregullatori i shpejtësisë:**

Kontrolli i gjendjes së rregullatorit të shpejtësisë

-
- Kontrrolli i pozicionit dhe i fiksimit ne shina/bazament*
 - Kontrrolli i kontaktit elektrik te rregullatorit në qarkun e sigurise*
 - Kontrrolli i paisjes me pesha për rregullatorin e shpejtesisë*
 - Kontrrolli i kavos dhe fiksimit i saj tek frenat e kabinës*
 - **Frenat e kabinës ose nofullat (Safety gear / Pawl/ Clamping Devices):**
 - Kontrrolli i kontaktorit elektrik.*
 - Kontrrolli i funksionimit dhe distances nga binari.*
 - Kontrrolli i lidheseve dhe shtrengimi.*
 - Kontrrolli i pjeseve levizese per levizje te lire.*
 - **Rreshqitesat e kabines:**
 - Kontrrolli i lubrifikimit (lyerjes me vaj ose me graso)*
 - Kontrrolli i kapeseve dhe shtrëngimi.*
 - Kontrrolli i konsumit dhe nevoja për ndërrim (veshje).*
 - **Kavot:**
 - Kontrrolli i elasticitetit dhe tensionit.*
 - Kontrrolli i lidhjeve korrekte.*
 - Kontrrolli shtrengimit te njejte te te gjithë kavove.*
 - **Shinat:**
 - Kontrrolli i lubrifikimit (vajisjes) ne pjesen aktive te shinave*
 - Kontrrolli i fiksimit neper stafa i shinave.*
 - **Celesat fundore:**
 - Kontrrolli i funksionimit te tyre dhe pozicioni*
 - **Lidhjet elektrike:**
 - Kontrrolli nepermjet vrojtimit te izolimeve dhe gjendjet e lidhjeve*
 - **Bordi elektronik:**
 - Kontrrolli i kabinetit qe te jete i paster, i thare dhe pa pluhur.*
 - Matja e rezistoreve, diodave, kapacitoreve etj, për vlerat nominale.*
 - **Inverteri:**
 - Kontrrolli i gjendjes së inverterit dhe fiksimit në mur.*
 - Gjendja e lidhjeve me motorin dhe me bordin elektronik.*
 - Ekranet dhe treguesit e tjere per funksione të caktuara.*
 - **Motori:**

Kontrrolli i kabllit te furnizimit elektrik të motorit.

Kontrrolli i frenave te motorit dhe aktivizimi/c'aktivizimi i tyre në kohë.

- ***Paisjet elektrike të sigurisë:***

Kontrrolli i funksionimit

Kontrrolli i qarkut elektrik te sigurise.

Kontrrolli i siguresave perkatese nëse janë të vendosura ne menyre korrekte.

- ***Sistemi emergjent i evakuimit:***

Kontrrolli i funksionit të sistemit emergjent te evakuimit

Ekipi sigurohet ne cdo vizite që ashensorët te lihen në gjendje të rregullt.

2. Mirembajtja e rregullt periodike e ashensorit

Mirembajtje e rregulle periodike e ashensorit perfshin:

- 1- Kontrollin njehere ne muaj te komponenteve te ashensorit sipas protokollit ne piken1 te specifikimeve teknike*
- 2- Riparimin e defekteve qe vijne si efekt i perdorimit normal i ashensorit*
- 3- Pergjigjen per raste emergjencash*

Nderhyrjet per riparimin e defekteve te ashensoreve (kohe pune, pa perfshire pjeset qe mund te nderrohen) qe vijne si pasoje e funksionit normal te ashensorit konsiderohen pjese e procesit standard te mirembajtjes dhe mbulohen nga tarifa e mirembajtjes se ashensorit.*

Koha e punes, si dhe pjeset e kembimit per riparimin e defekteve qe vijne si efekt i:

- Keqperdorimit*
- Pakujdesive*
- Prezences se lageshtires dhe ujit ne kafaz dhe komponente*
- Perdorimit te ashensoreve per transport te objekteve/mallrave*

nuk konsiderohen pjese e procesit standard te mirembajtjes dhe mbulohen nga tarifa e mirembajtjes se ashensorit.

**Defekte qe vijne nga funksionimi normal i ashensorit quhen te gjitha defektet qe nuk shkaktohen nga keqperdorimi, perdorimi jo i kujdeshem, luhatjet e energjise elektrike, lageshtira dhe uje ne elementet e ashensorit, ushtrimi i dhunes ne kabine, dyer etj, nderhyrja e personave te pa-autorizuar ne elemente te ashensorit, etj.*

3.Njoftimi per raste defektesh

Per te siguruar venien ne pune sa me te shpejte te ashensorit ne raste defektesh, keto defekte duhet te njoftohen menjhere ne njerin nga numrat e Qendres se Thirrjes se Operatorit Ekonomik. Ky numer duhet te afishohet ne brendesi te kabines.

4.Nderhyrja nga persona te pa-autorizuar

Gjate kohes te kontrates se mirembajtjes, personat te pa-autorizuar (qe nuk jane staf i Operatorit Ekonomik) e kane absolutisht te ndaluar te bejne mirembajtje, riparime apo cdo lloj nderhyrje tjeter ne ashensoret subjekt i kesaj kontrate.

5.Riparimet e defekteve

Ne raste defektesh, Operatori Ekonomik do te beje riparimin e tyre brenda nje kohe sa me te shkurter te mundshme. Ne raste defektesh ku pjese kembimi duhet te riparohen apo nderrohen,

kthimi ne funksion i ashensorit do te varet nga koha e riparimit te defektit apo ardhjes se pjeses perkatese.

Operatori Ekonomik do te vere ne dispozicion te pales kontraktuese nje raport ne lidhje me defektin, pjeses se defektuar, koston dhe kohes se riparimit/ardhjes se ashensorit.

6.Lenia jashte funksionit e ashensorit

Ne rastet kur ekipi i servisimit konkludon se ashensori nuk eshte ne gjendje te rregullt, dhe se rrezikohet siguria e perdoruesve, stafit apo e ashensorit, ekipi duhet te nxjerr ashensorin jashte funksionit deri ne riparimin e problemit.

Personat pergjegjes nga Autoriteti Kontraktor njoftohen zyrtarisht per lenien e ashensorit jashte funksionit, arsyen si dhe kohen e parashikuar te kthimit ne funksion te ashensorit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER LOTIN 2

Mirembajtja e gazerave mjeksore, paneleve diellore dhe kondicionerave

Mirembajtja e Kondicionereve

Kontroll i presionit dhe mbushje me gaz R407 & R410A & R32 per kondicionere 9000/12000/18000 btu/h

Cmontim Riparim Montim pakete kondicioneri 9000/12000/18000 btu

Cmontim Furnizim Montim Elektrovalvol tre rrugshe kondicioner 9000/12000 /18000 btu/h

Cmontim Furnizim Montim Kondesator 30 mikrofaraad 9000/12000 /18000 btu/h

Cmontim Furnizim Montim Kondesator 60 mikro faraad 9000/12000 /18000 btu/h

Zmontim Avolzhim Montim motorr kompresori kondicioneresh

Furnizim vendosje sistemim tub shkarkimi I kondensatit

Cmontim Furnizim Montim sensor ajri 9000/12000 /18000 btu/h

F.V.kondicioere 12 BTU

Mirembajtja e sistemit te gazeve mjeksore

F.V.prize oksigjeni

F.V.fuksometra +lagehtues _____

- ✓ Preventivi përmban zonën e kryerjes së shërbimeve teknike, llojin dhe specifikimin teknik të shërbimit të riparim-mirëmbajtës, njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve. Pjesë e preventivit është pasqyra me të dhënat teknike të ashensorëve sipas godinave ku janë të instaluar.*
- ✓ Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të çertifikuara (CE).*

- ✓ Ofertuesit të njihen me ashensorët dhe të deklarojnë që marrin përsipër kryerjen e këtyre riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë dhe me cilësinë e kërkuar për shërbim spitalor.
- ✓ Ofertuesit të kenë persona përgjegjës, të kualifikuar për kryerjen e riparimit të çdo defekti të mundshëm, duke i deklaruar ato me lidhjen e kontratës.
- ✓ Sipërmarrësi duhet të kontaktojë çdo ditë me përfaqësuesin e spitalit , për ndjekjen e zbatimit të kontratës.

Mirembajtja e paneleve diellore fotovoltaike

Pastrim larje me solucion perkates te paneleve diellore

Kontroll I siguresave DC dhe zvendesimi I tyre nese jane djegur

Pastrim me kompresor te inverteve te paneleve diellore

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Loti 1 - Mirembajtja e ashensoreve

NR	EMERTIMI I SHËRBIMEVE	NJESIA	SASIA	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
	Mirembajtja e ashensorit te Maternitetit vit prodhimi 2020				
1	Mirembajtja e rregullt periodike e ashensorit ku perfshin sherbimet si me poshte: a- Kontrollin njehere ne muaj te komponenteve te ashensorit sipas protokollit ne piken1 te specifikimeve teknike b- Riparimin e defekteve qe vijne si efekt i perdorimit normal i ashensorit pa pjese kembimi c- Pergjigjet per raste emergjencash d- Nderhyrjet per riparimin e defekteve te ashensoreve me pjese kembimi	komplet	12	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
	Mirembajtja e ashensorit te Spitalit vit prodhimi 2014				
	Mirembajtje e rregullt periodike e ashensorit ku perfshin sherbimet si me posht: a- Kontrollin njehere ne muaj te komponenteve te ashensorit sipas protokollit ne piken1 te specifikimeve teknike b- Riparimin e defekteve qe vijne si efekt i perdorimit normal i ashensorit pa pjese kembim c- Pergjigjen per raste emergjencash d- Nderhyrjet per riparimin e defekteve te ashensoreve me pjese kembimi	komplet	12	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK

Loti 2 - Mirembajtja e gazerave mjeksore, panelve diellore dhe kondicionerave

NR	EMERTIMI I SHERBIMEVE	NJESIA	SASIA	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
	Mirembajtja e ashensorit te Maternitetit vit prodhimi 2020				
	Mirembajtja e Kondicionereve				-
10	Kontroll i presionit dhe mbushje me gaz R407 & R410A & R32 per kondicionere 9000/12000/18000 btu/h	Kg	16	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
11	Cmontim Riparim Montim pakete kondicioneri 9000/12000/18000 btu	Cope	4	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
12	Cmontim Furnizim Montim Elektrovalvol tre rrugshe kondicioner 9000/12000 /18000 btu/h	Cope	6	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
13	Cmontim Furnizim Montim Kondesator 30 mikrofarad 9000/12000 /18000 btu/h	Cope	3	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
14	Cmontim Furnizim Montim Kondesator 60 mikro farad 9000/12000 /18000 btu/h	Cope	6	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
15	Zmontim Avolzhim Montim motorr kompresori kondicioneresh	Cope	3	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
16	Furnizim vendosje sistemim tub shkarkimi I kondensatit	m.l	10	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
17	Cmontim Furnizim Montim sensor ajri 9000/12000 /18000 btu/h	Cope	6	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
18	F.V.kondicioere 12 BTU	Cope	2	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
	Mirembajtja e paneleve diellore fotovoltaike				
1	Pastrim larje me solucion perkates te paneleve diellore	Cope	316	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
2	Kontroll I siguresave DC dhe zevendesimi I tyre nese jane djegur	ore /pune	10	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
3	Pastrim me kompresor te inverteve te paneleve diellore	ore /pune	8	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
	Mirembajtja e sistemit te gazeve mjeksore			Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
1	F.V.fuksometra +lagehtues	Cope	20	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
2	F.V.parangrohes protoksidi	Cope	1	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
3	F.V bombel oksigjeni 15 LT (komplet)		20	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
4	F.V.reduktor oksigjeni per bombolat e ambulancave	Cope	6	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK
5	F.V pistolete ajri + aksesor perkates		2	Spitali Rajonal Lezhe	Brenda afatit te MK

Afatet e ekzekutimit: Autoritetet Kontraktore do të lidhe me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedurat e prokurimit, kontrata bazuar në nevojat e tyre brenda një periudhe 12 mujore.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “**Mirembajtja e impjanistikës për nevoja të Spitalit Rajonal Lezhe - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”e ndare në dy lote.**

Detyrat:

Mirembajtja e impiantistikës të Spitalit Rajonal Lezhe do të bëhet për një periudhë 12 mujore.

1. Mirembajtja e ashensoreve të spitalit dhe Maternitetit

Spitali Rajonal Lezhe ka dy ashensore një i instaluar në godinën e spitalit dhe një në godinën e Maternitetit

Te dy ashensorët e montuar në spital edhe në Maternitet janë jetësorë për funksionimin normal të punës në spital, prandaj është shumë e domosdoshme kryerja e mirembajtjes preventive mujore të jete specifike sipas kushteve dhe standarteve të përcaktuara në katalogun e tyre nga prodhuesi.

2. Mirembajtja e sistemit të gazeve mjekësore

Një pjesë shumë të rëndësishme e punës në spital është edhe sistemi I gazve mjekësore, prandaj është kërkuar vendosja e dy parangrohësve të protoksidit, fluksometrat e oksigjenit, bombolat e oksigjenit për ambulancat, prandaj edhe këto materiale duhet të jenë çilesore për të garantuar çilësinë në punë.

3. Mirembajtja e paneleve diellore

Në spital janë të montuara 316 panele diellore fotovoltaike dhe për të maksimizuar prodhimin e energjisë elektrike kërkohet të bëhet mirembajtja e tyre sipas protokollit të përcaktuar në preventivin e mesiperm.

Thëksojmë që operatori duhet të jetë i gatshëm për kryerjen e mirembajtjes dhe riparimit të këtyre në kohë record, pasi mungesa e tyre për shkak të qenies me defekt shkakton probleme të mëdha në funksionimin dhe mbarevatjen e punës në spital.

4. Mirembajtja e kondicionereve

Në spital dhe në godinën e Poliklinikës janë të montuar mbi 80 kondicionere prandaj është shumë e nevojshme mirembajtja e tyre sipas zerave të përcaktuara në preventiv.

Shpërndarja: Në godinat e Spitalit dhe Maternitetit

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT PER LOTIN 1

Ofertuesi deklaron se:

-
- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

-
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
 - Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Shuma e sigurimit të ofertës është: 12,000.00 (dymbëdhjetë mijë) leke.
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit, do të jete 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës ose lotit.

Vlera mesatare e xhiros së këtyre tre viteve duhet të jetë : 240,000.00 (dyqind e dyzete mijë) leke.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë 20% të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, do të jetë: 120,000.00 (njqind e njqzete mije) leke

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikate:

- *ISO 9001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësive (te vlefshme).*
- *ISO 45001 ose ekuivalente, për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (te vlefshme).*

Certifikatat ISO duhet të jenë e leshuar nga organizma të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). Objekti i certifikimit të mbulojë apo jete në linjë me objektin e procedurës së prokurimit.

2.3.3 *Deklarate për përmbushjen e afatit të garancisë. (minimumi 1 vjet garanci, përfshirë blerjen dhe zëvendësimin e pjesëve të dëfektuara me pjesë këmbimi të reja origjinale ose ekuivalente me ato të përdorura në fillim nga prodhuesi).*

2.3.4 *Operatori ekonomik duhet të provojë që çdo pjesë furnizim vëndosje, duhet të ketë origjinë nga prodhuesi, vërtetuar kjo me autorizim mbështetje me pjesë këmbimi leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar në emër të operatorit ekonomik.*

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të disponojë licencën zbatimi NS 3-A për montimin e impianteve ngritëse dhe transportuese. Në përmbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën e zbatimit të shoqërisë.*

2.3.6 *Operatori ekonomik duhet të provojë që ka të paktën 4 të punësuar nga të cilët të paktën dy punonjës specialiste për riparimin e ashensoreve .*

Personeli i mesiperm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e trajnimit të sigurimit teknik.

